

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT BARLETI**

**DHE**

**ALBACADEMY**

**TIRANË**

**ME DATË 21/10/2022**

**ALBACADEMY** mri i Biznesit përfaqësuar nga **Valbona Begolli**, funksioni **Administrator**, është institucion privat, veprimtaria e të cilit bazohet në ligjet në fuqi të Shtetit Shqiptar,

adresat: Rruga Autostrade "Tiranë- Durrës" Tirana Industrial Park Kapanoni nr 27

068

**UNIVERSITETI BARLETI** përfaqësuar nga Dr. Rezart Prifti, funksioni zv. Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes, dhe Drejtësisë, përgjegjës i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes, dhe Financës, është institucion privat (universitet), veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr.8788

Adresa: Universiteti Barleti | Rr. Frang Bardhi, Selitë | 1001, Tiranë

## VEQËNËSE

- A. **ALBACADEMY** është themeluar në vitin 2018 dhe ka selinë qendrore në Tiranë. Kompania ka shtrirje rajonale dhe vepron në gjithë territorin e Shqipërisë, në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Kompania është pjesë e Kompanisë "Albpastrim" dhe zhvillon veprimtari në fushën e trajnimit, konsulencës, këshillimit (coaching) dhe kërkimit. Me anën e trajnimeve të saj Kompania ofron aftësi profesionale në profesionet e zgjedhura dhe mundëson planifikimin dhe përcaktimin e karrierën së klienteve kryesisht të të rinjve.

*kompania kompanija:*

### **Konsulence dhe coaching në fushat:**

- Menaxhim biznesi
- Strategji biznesi
- Paketa biznesi
- Startup-s

### **Trajnime në fushat:**

#### **1. Zhvillim Biznesi**

- Turizëm
- Agrobiznes
- Finanee
- Marketing
- Shitje



- Menaxhim
  - Zhvillim personal dhe profesional
2. **ICT**
- Programim
  - Software
  - Web Design
  - Graphic Design
  - CTO
3. **Higjene / Pastrim**
- Housekeeping
  - Pastrimi i shtëpisë
  - Supervizim pastrimi
  - Sanitim
  - Haccp
  - Higjena gjatë pandemisë Covid-19
4. **Kërkime**
- Zhvillim biznesi
  - Vlerësim nevojash për trajnim dhe zhvillim

## B. UNIVERSITETI BARLETI

Universiteti Barleti është institucion jopublik i arsimit të lartë krijuar në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. 571, dt. 12.08.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private Marin Barleti", me dy fakultete dhe pesë programe studimi.

Universiteti Barleti është i pari institucion i arsimit të lartë në Shqipëri që u ngrit nën drejtimin e kualifikuar të një Bordi Akademik. Që nga koha e hapjes së tij, Universiteti Barleti, punon për të krijuar një profil të qëndrueshëm, dinamik me programe cilësore, bashkëkohore që gërshetojnë akademinë dhe kërkimin shkencor sipas kërkesave gjithmonë në rritje dhe ndryshim të tregut të punës dhe sfidave të zhvillimit.

Që në gjenezën e tij, Universiteti Barleti ka zhvilluar në rritje një ofertë akademike ndërdisiplinore në fushat më të spikatura nga kërkesa e tregut, shoqërisë, politikës, ambjentit. Diplomat e tij mbulojnë sektorë si: biznes, teknologji informacioni, drejtësi, mësuesi në sporte, dizajn, shkenca sociale, arkitekturë, urbanistikë, etj dhe krijojnë mundësi jo vetëm për programe akademike të të tre niveleve por dhe për formim profesional nëpërmjet programeve të veçanta. Në rrugëtimin e tij, institucioni ka mundësuar jo vetëm studimet profesionale dhe të aplikuara universitare, e pasuniversitare, por dhe shërbime të tjera si ato të testimit dhe programeve të trajnimit të vazhdueshëm



profesional dhe liçensimit, nëpërmjet bash- këpunimeve të shumëllojshme me organizma profesionale, shoqata dhe punëdhënës.

C. Ekziston një vullnet i lirë i palëve që të bashkëpunojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta për:

- ✓ Shkëmbimin e eksperiencave më qëllim realizimin e praktikës mësimore dhe punësimit të studentëve dhe të të diplomuarëve në Universitetin BARLETI.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e asistencave teknike dhe profesionale reciproke duke vënë në dispozicion kapitalin intelektual të palëve.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e iniciativave të përbashkëta për aplikimin në projekte, në programe të edukimit afat shkurtër, konsulencave të specializuara, etj.
- ✓ Aplikimi dhe Implementimi i projekteve dhe programeve të financuara me fondet e EU, apo donatoreve të ndryshëm ndërkombëtar si USAID, WB, IFC, EBRD, Qeveria Shqiptare, dhe jo vetëm.

**PALËT BIEN DAKORD si vijon:**

## **NENI I**

### **OBJEKTIVI**

Palët e kësaj marrëveshje Bashkëpunimi, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpiqen të përforojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në edo fushë të kësaj marrëveshje.

## **NENI II**

### **FUSHAT E BASHKËPUNIMIT**

1. **ALBACADEMY** do të angazhojë, sipas një plani të caktuar, student dhe të diplomuar të universitetit në punë promovuese, nëse ekziston gatishmëria dhe dëshira e mirë e personave në fjalë.



2. ALBACADEMY në kuadër të veprimtarisë së vet, do t'ju mundësojë studentëve të universitetit BARLETI kryerjen e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor. Dinamika e realizimit të punës praktike do të përcaktohet me dokumentacion të vecantë që specifikon detyrimet e palëve për çdo grup praktike të çdo fakulteti.
3. Ekspertë të ALBACADEMY do të kenë mundësinë të mbajnë në universitetin BARLETI leksione për promovimin e institucionit të tyre dhe të veprimtarisë së tij.
4. Universiteti BARLETI do të aplikojë tarifa preferenciale për anëtarët e stafit të ALBACADEMY të cilët do të ndjekin studimet në programet e studimit të universitetit.
5. Palët do të realizojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, promovuese dhe marketing, me qëllim rritjen e cilësisë, imazhit të institucioneve respektive si dhe sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
6. Palët do të zhvillojnë forume të përbashkëta, konferenca shkencore, simpoziume, seminare, dhe shumë veprimtari të tjera të këtij lloji me interes reciprok.
7. Palët do të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta promovuese dhe marketing, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
8. Palët do të shkëmbejnë materiale akademike dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.
9. Universiteti BARLETI do të zhvillojë tarifa preferenciale për të gjitha studimet, konsulentat, këshillimet apo trajnimet që do të realizojë për ALBACADEMY

## NENI III

### KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje Bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakort ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjes së vecantë financiare, të cilat do të jenë pjese integrale e kësaj Marrëveshje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, njeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e profesional, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetëm me aprovimin e të palëve. Palët ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të përfituara nga njëri-tjetri.
6. Palët dakordohen që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

## NENI VI

**EFEKTET E KESAJ MARREVESHJE**

Kjo marrëveshje mirëkuptimi nuk përbën ose krijon dhe nuk ka për qëllim të përbëjë ose të krijojë detyrime ligjore detyruese ose të zbatueshme, të shprehura ose të nënkuptuara.

**NENI V**

**PERSONAT E KONTAKTIT**

Për të zbatuar objektivat e shprehura më sipër palët mirëkuptohen dhe bien dakort në mënyrë reciproke për sa më poshtë:

1. Propozimet për bashkëpunim sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të paraqiten përmes personave të kontaktit të caktuar nga secili institucion.
2. Për Universitetin BARLETTI person kontakti është Rezart Prifti në cilësinë e përgjegjës të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës dhe zv/Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, r.prifti@umb.edu.al, 0692092960.
3. Për ALBACADEMY person kontakti është FLORENTINA ARIFAJ, Drejtor burime nerezore ALBACADEMY, e-mail: [fin@albgroup.al](mailto:fin@albgroup.al), cel: +355676040096.

**NENI VI**

**HYRJA NE FUQI DHE KOHËZGJATJA**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit mes palëve dhe lidhet për një periudhë trevjecare, me të drejtë rinovimi pas kërkesës dhe pëlqimit të dy palëve. Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në republikën e Shqipërisë. Ajo mund të ndryshohet në çdo moment nëse palët bien dakord dhe vetëm me anë të një dokumenti të shkruar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kjo marrëveshje shfuqizon çdo marrëveshje ndërmjet palëve,

Universiteti BARLETTI

Dr. Rezart Prifti

Zv. Dekan



ALBACADEMY

Valbona Begolli

Administratore


